



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 193, Datë 20.11.2020

“MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS TIP PËR
VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË HAPËSIRAT E DEPOZITIMIT TË GAZIT
NATYROR”.**

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe seksionit II, neni 22, 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 123/1 prot., datë 19.11.2020 për fillimin e procedurës për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike;

Konstatoi se:

- Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën TIP në veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.
- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimet e të licencuarit mbështetur në parashikimet e Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.
- Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është organi i ngarkuar nga Ligji nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, me të drejtën për të dhënë licencë të operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.
- Të licencuarit që fitojnë të drejtën për të ushtruar aktivitetin e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, janë subjekt të kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s për licencimin.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e licencës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror.
2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI